



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.596/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Skenderaj, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.596/2025, e datës 19.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 19.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në të cilën pretendohet se me datë 19.02.2025 në tavolinën nr.9 gjatë numërimit të fletëvotimeve në vendvotimin 1913/01, dëshmitarët Rinor Zhdrella dhe komisioneri numëruar Idriz Kika kanë vërejtur se dy fletëvotime kanë qenë të prera dhe të njëjtat nuk kanë as numër identifikimi e as numër rendor. Parashtruesi i ankesës po ashtu pretendon se të njëjtat fletëvotime duhet të cilësohen të pavlefshme, por trajnerja e Lëvizjes Vetëvendosje që është angazhuar në KKZ-në në Prishtinë ka bërë presion maksimal te kryesuesja e tavolinës nr.9 duke i kthyer këto fletëvotime nga të pavlefshme në të vlefshme.

PZAP iu drejtuar me kërkesë për përgjigje me datën 19.02.2025. Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja Gjatë procesit të verifikimit dhe numërimit vlejné procedurat e numërimit në VV, sipas Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim

dhe Menaxhimi i Vendvotimit. Neni 16 paragrafi 2 Rregullore Zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, thekson se: Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit: ne zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e vlefshme nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik, Rasti konkret, i pretenduar nga ankuesi nuk hynë në kategorinë e fletëvotimeve të pavlefshme, siç parashihet në dispozitat e lartcekura, sepse qëllimi i votuesit është i qartë, është votuar një subjekt politik dhe kandidatë të caktuar. Së këto dy fletë votime janë të vlefshme, KKZ-ja e Prishtinës, ka dërguar edhe Amën, me numrat serik të këtyre dy fletëvotimeve të cilat janë specifikuar në ankesë. Pretendimet e ankuesit rreth fletëvotimeve të cilat i ka siguruar si argumente rreth kutisë 1913/01, sipas kryesueses në Ekipin e Numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (tutje QKN), Blerina Bytyçi, fletëvotimet e targetuara nga ankuesi, janë vlerësuar nga Ekipi e Numërimit si të vlefshme pasi që në materialin zgjedhor brenda kutisë gjenden edhe amat e fletëvotimeve. Njëherit, pranimi i fletëvotimeve në Qendrën e Votimit 1913, Vendvotimi 01 është në përputhje me Formularin e Rezultateve të Subjekteve (FRS), mes nënshkrimeve në Listën e Votuesve dhe Fletëvotimet në thesin numër 4, ku gjenden të gjitha fletëvotimet e vlefshme. Ndërsa, sa i përket fotos së trajneres së KKZ-së në Prishtinë, të gjithë trajnerët janë të akredituar nga Komisioni Qendror Zgjedhor të cilët janë pranuar përmes konkursit të hapur dhe kanë kaluar hapat deri në rekrutim nga KQZ. Aludimet e ankuesit se ka interferuar trajneri i "Vetëvendosjes" është i pa-bazë dhe tendencioz. Andaj edhe një herë e bëjmë të qartë se trajnerët janë të përzgjedhur në bazë të kriterëve të shpallura në konkursin e KQZ së, pa preferenca partiake. Njëherit si KKZ-Prishtinë jemi të shqetësuar me faktin se është cenuar privatësia e trajnerë në fjalë. Kryesuesja e në deklaratën e saj deklaroi, se ekipi i Numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit në Prishtinë fletëvotimet në fjalë i kam konsideruar si të vlefshme pasi që si të tilla i kemi trajtuar me Ekipin e Numërimit brenda QKN-së. Po ashtu, fletëvotime të vlefshme kanë qenë edhe brenda kutisë ku janë numëruar edhe ditën e zgjedhjeve më 09 shkurt 2025, dhe i kam klasifikuar dhe kam ndjekur rrugën e njëjti si Ekipi në Këshillin e Vendvotimit. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë si provë ka lidhur me deklaratimet e mësipërme ka bashkangjitur Nr. 1. Ama fletëvotimit nr. serik 1971451 dhe ama e fletëvotimit me numër serik 1971452, 2. Formulari i Rezultateve të Subjekteve Politike (FRS), përgjigje e KKZ-së dhe deklaratata e kryesuesit të ekipit të numërimit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi të gjitha shkresat e lëndës, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LDK me të cilën pretendon se për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në KKZ Prishtinë, dy fletëvotime kanë qenë të prera dhe nuk kanë pasur numër identifikimi dhe numër rendor, Paneli i vlerësoi si të paqëndrueshme, pasi që i njëjti pretendim nuk qëndron për arsye se, në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara me përgjigjen në ankesë nga KQZ vërtetohet se dy fletëvotime përmbajnë numër serik.

Bazuar në të lartcekurat, paneli duke u mbështetur në nenin 16 paragrafin 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, konstaton se votat konsiderohen të vlefshme vetëm në rastet si në

vijim: “Është i vulosur, ka numër serik të VV përkatës, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit”. Prandaj në rastin konkret dy fletëvotimet të cilat janë shpallur të vlefshme hyjnë në kategorinë fletëvotimeve të vlefshme siç e parashohin dispozitat ligjore e lartcekur. Andaj, duke u bazuar ne konstatimet e lartcekura Paneli e refuzoj ankesën dhe vendos si ne dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, pasi qe barra e të provuarit për faktet e pretenduara bie mbi ankuesin.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 4, lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 par.10 nënpar.10.1 të Rregullores së PZAP-së (Nr.01/2024), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.596/2025, datë 20.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.